



**VENDIM**

*Nr. 76, datë 07.06.2016*

**MBI**

**FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR SHQYRTIMIN E APLIKIMIT TË  
OST SH.A. PËR PËRCAKTIMIN E TARIFËS SË SHËRBIMIT TË  
TRANSMETIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE PËR PERIUDHËN 1  
KORRIK 2016 – 31 DHJETOR 2016**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 21 të Ligjit nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” neneve 18, 20 dhe 21 të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 21, datë 18.3.2009, i ndryshuar, Vendimin nr 59 date 29.12.2005 “Metodologjia e llogaritjes se tarifës se aktivitetit te transmetimit te energjisë elektrike”, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 07.06.2016, pasi shqyrtoi aplikimin e OST sh.a. për përcaktimin e tarifës së transmetimit të energjisë elektrike për periudhën 1 Korrik 2016 – 31 Dhjetor 2016, dhe relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Çmimeve dhe Tarifave,

**Konstatoi se:**

- Aplikimi plotëson kryesisht kërkesat e përcaktuara në rregullat e ERE-s, për fillimin e procedurave të shqyrtimit të aplikimit për përcaktimin e tarifës së shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike nga OST sh.a. për periudhën 1 Korrik 2016 – 31 Dhjetor 2016.

Për gjithë sa më sipër Bordi i ERE,

**Vendosi:**

1. Fillimin e procedurave për shqyrtimin e aplikimit të OST sh.a. për përcaktimin e tarifës së shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike nga OST sh.a. për periudhën 1 Korrik 2016 – 31 Dhjetor 2016.
2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë shoqërinë OST sh.a. për vendimin e Bordit të ERE.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI I ERE**  
**Petrit AHMETI**